



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 21
Prishtinë, më 19.5.2015, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi, dhe Nezir Çoçaj.

Munguan: Fatmir Limaj, Agim Aliu, Doruntinë Maloku dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Hamit Mjeku-praktikant; Naim Jaka-GP VV; Lekë Batalli-GPLS; Petrit Hysaj-OSBE; Arton Demhasaj-“ÇOHU”; Florina Merovci-ZPRK; Alma Tafarshiku-EULEX; Valdet Hajdini-IKD; Etleva Ikonja-“Kosova Sot”; Yll Zekaj-OAK; Gentiana Dushi-praktikante; Ardian Bajraktari-MD.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.4.2015;
3. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës,
4. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryetarja** konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.4.2015

***Kryetarja** konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 14.4.2015, pa vërejtje.*

3. Shqyrtimi i propozimeve për emërimin e anëtarëve të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës

Kryetarja, pasi lexoi emrat e propozuar për anëtarë të Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës, theksoi se disa nga ata nuk i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara me Ligjin për provimin e Jurisprudencës, sipas të cilit anëtarët duhet të kenë përvojë pune prej 12 vjetësh në sistemin e drejtësisë. Ajo theksoi se nuk e përkrah këtë kriter aq të lartë, dhe se pasojat po i vuajnë studentët për këtë vonesë, por faji i mbetet MD-së, kurse ne nuk mund t'i shkelim kriteret ligjore. Ajo ftoi anëtarët e Komisionit që ta përkrahin atë, për të bërë një raport që mos të votohen në seancë anëtarët që nuk i plotësojnë kriteret.

Armend Zemaj, theksoi se ka kaluar një kohë e gjatë pa u kompletuar Komisioni për Provimin e Jurisprudencës, andaj ka ardhur koha që t'i jepet zgjidhje kësaj çështjeje. Ai theksoi se kur jemi te kriteri ligjor i 12 vjetëve përvojë pune në sistemin e drejtësisë, është menduar më shumë në fushën e drejtësisë dhe anëtarët e propozuar të gjithë janë juristë të shquar, andaj konsideroj se Komisioni duhet të jetë më fleksibil dhe t'i procedojë tutje për t'u votuar. Por, nëse nuk procedohen tutje, propozoi që të jepet një javë kohë që të shqyrtohet dokumentacioni dhe të marrim një interpretim ligjor në lidhje me çështjen kontestuese. Ose shkojmë për seancë, por me mendimet e kundërshtimet e secilit anëtar të Komisionit dhe atij t'ia paraqesim në seancë.

Kryetarja, theksoi se jemi në një situatë ku nuk është përgjegjës Komisioni, por MD-ja dhe nuk mund ta shkelim ligjin.

Selviqe Halimi, theksoi se kur kemi të bëjmë me situata të tilla interpretimeve ligjore, nuk duhet shikuar vetëm dispozita si e tillë, ngase në këtë rast është shumë e ashpër, por duhet shikuar në frymën e ligjit, andaj do të ishte mirë që ta procedojmë për seancë. Procedimi për seancë mund të bëhet edhe me një kërkesë që, ose ta bëjmë plotësim-ndryshimin e ligjit në lidhje me përvojën e punës, ose të kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë që të bëjë zëvendësimin e këtyre njerëzve konform asaj dispozite.

Armend Zemaj, theksoi përsëri se mund të jetë lëshuar ndonjë gabim, kur kemi të bëjmë me përvojën e punës prej 12 vitesh.

Nezir Çoçaj, theksoi se unë nuk jam për ta votuar as në seancë, e as në Komision një vendim të ardhur nga Qeveria, respektivisht nga Ministria e Drejtësisë, që është në kundërshtim me ligjin. Andaj është mirë që t'i kthehet MD-së dhe të kërkohen anëtarë, në përputhje me ligjin.

Donika Kadaj-Bujupi, theksoi se edhe ajo pajtohet që lista e kandidatëve t'i kthehet MD-së dhe po i njëjti institucion të sjellë listën në përputhje me ligjin.

Agim Ademaj, theksoi se do të ishte mirë që ta dërgojmë në seancë, me kusht që të jetë prezent ministri i Drejtësisë dhe të shpjegojë tërë këtë.

Visar Krasniqi, theksoi se në këtë fazë, ne duhet ta dërgojmë në Kuvend raportin me rekomandim, të miratohet ose të mos miratohet, sepse nëse vetëm themi të shqyrtohet, kjo nuk i ofron zgjidhje Kuvendit, sepse gjithçka që shkon në Kuvend, sigurisht që shqyrtohet.

Nezir Çoçaj, theksoi se nëse ne shohim shkelje ligjore, pse duhet të presim që seanca ta kthejë në Ministrinë e Drejtësisë, kur një gjë të tillë mund ta bëjmë ne.

Kryetarja, theksoi se ajo përkrah propozimin që ta procedojmë në seancë dhe të rekomandojmë për mosvotim, në mënyrë që të largojmë përgjegjësinë nga Komisioni për Legjislacion dhe të kërkojmë sqarim në lidhje me këtë çështje nga ministri.

Donika Kadaj-Bujupi, kishte një propozim që të ftohet ministri në Komision dhe aty të japë sqarimet e nevojshme.

Kryetarja, theksoi se e përkrah këtë propozim, që të ftohet ministri, andaj do të tentojmë që një gjë e tillë të bëhet.

Pas diskutimeve, Komisioni me 5 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, nxori këtë:

Përfundim

Ftohet Ministri i Drejtësisë, z. Hajredin Kuçi, që të marrë pjesë në mbledhjen e radhës së Komisionit, që të ofrojë sqarime lidhur me propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës.

4. Shqyrtimi i raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetarja, tha se Komisioni, për ta përmbushur obligimin e tij të përcaktuar me nenin 73 të Rregullores së Kuvendit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nga fusha e përgjegjësisë së tij, ka ushtruar mbikëqyrjen e Ligjit 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale. Për të realizuar këtë mbikëqyrje, Komisioni ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe në Lipjan.

Pas vizitave në institucionet e theksuara, është hartuar raporti që ju e keni para vetes, me të gjeturat faktike, përkitazi me zbatimin e këtij ligji me rekomandimet e nevojshme për institucionet e autorizuar, që e kanë obligim zbatimin e këtij ligji.

Donika Kadaj-Bujupi, theksoi se duhet të fuqizohen rekomandimet, kur kemi të bëjmë për Panelin me Lirim me Kusht, ngase edhe kërkesat kanë qenë më shumë në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, edhe për çështjen e amnistisë ka pasur shumë ankesa.

Armend Zemaj, theksoi se pjesë e raportit duhet të jetë edhe moslejimi i vizitës në Pavijonin “D” në QK në Dubravë, në mënyrë që të jetë informimi i saktë, dhe për aktorët e interesuar të bëhet me dije një gjë e tillë. Pra, të paraqesim faktin se nuk jemi lejuar për vizitë, pa asnjë arsytim ligjor.

Kryetarja, theksoi se pajtohet me atë që u tha në lidhje me Pavijonin “D” dhe se institucionet përkatëse nuk po marrin përgjegjësinë për të kthyer përgjigje për këtë çështje. Ndërsa, sa i përket faljes, është shumë e rëndësishme që të diskutohet në Kuvend, ngase kishte shumë të burgosur që i plotësojnë kushtet, por nuk po e gëzojnë këtë të drejtë.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të shqyrtohet dhe të miratohet raporti me rekomandime i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale.

4. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 9:50.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
